



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 139/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Anullimin e procedurës së prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me objekt “*Hartim Projekt preventiva zbatimi për rikonstruksionin e Godinave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, Godina e Anatomisë dhe Salla e Leksioneve të godina e paraklinikut*”, me nr. REF-81547-12-09-2020, me fond limit 11,687,500 lekë (pa TVSh), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Gjeokonsult & Co” ShPK  
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, P.45, Shk.01, K.II, Tiranë.
- Autoriteti kontraktor:** Universiteti i Mjekësisë, Tiranë  
Adresa: “Rruga e Dibrës”, Nr. 371, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, duke mosrespektuar shkallët e ankimit;

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.12.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me objekt “*Hartim Projekt preventiva zbatimi për rikonstruksionin e Godinave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, Godina e Anatomisë dhe Salla e Leksioneve të godina e paraklinikut*”, me nr. REF-81547-12-09-2020, me fond limit 11,687,500 lekë (pa TVSh), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

II.2. Në datën 21.12.2020, autoriteti kontraktor zhvilloi fazën e parë të procedurës së prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 30.12.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës lidhur me short-listimin për procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.4. Bazuar në parashtrimet bëra në ankesë nga operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult & Co” ShPK, ky i fundit pretendon se në datën 22.01.2021 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.5. Bazuar në parashtrimet bëra në ankesë nga operatori ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 23.02.2021 është njoftuar në rrugë postare lidhur me vlerësimin e ofertave teknike, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Bazuar në parashtrimet bëra në ankesë nga operatori ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 05.03.2021 është zhvilluar procedura e hapjes së ofertave ekonomike për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Bazuar në parashtrimet bëra në ankesë nga operatori ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 19.03.2021 është njoftuar në rrugë postare lidhur me vlerësimin përfundimtar, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datën 23.03.2021, operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult & Co” ShPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, ku ndër të tjera argumenton:

*“[...]Duke qenë se kjo është një procedurë që i përket rindërtimit në bazë të nenit 42 , pika 10 e Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e pasojave të Fatkeqësisë natyrore” ku shprehet se kundër vendimit të AK për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve dhe meqenëse data 22.03.2021 ishte pushim zyrtar “Dita e Nevruzit” , po jua dërgojmë sot ankesën tonë, e cila është brenda afatit.[...]”*

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur,

#### Arsyeton

III.1. Në datën 10.12.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me objekt “*Hartim Projekt preventiva zbatimi për rikonstruksionin e Godinave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, Godina e Anatomisë dhe Salla e Leksioneve te godina e paraklinikut*”, me nr. REF-81547-12-09-2020, me fond limit 11,687,500 lekë (pa TVSh), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

III.1.1. Në datën 21.12.2020, autoriteti kontraktor zhvilloi fazën e parë të procedurës së prokurimit, objekt ankimi.

III.1.2. Në datën 30.12.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës lidhur me short-listimin për procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.1.3. Bazuar në parashtrimet e bëra në ankesë nga operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult & Co” ShPK, ky i fundit pretendon se në datën 22.01.2021 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.4. Bazuar në parashtrimet bëra në ankesë nga operatori ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 23.02.2021 është njoftuar në rrugë postare lidhur me vlerësimin e ofertave teknike, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.5. Bazuar në parashtrimet bëra në ankesë nga operatori ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 05.03.2021 është zhvilluar procedura e hapjes së ofertave ekonomike për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.6. Bazuar në parashtrimet bëra në ankesë nga operatori ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 19.03.2021 është njoftuar në rrugë postare lidhur me vlerësimin përfundimtar, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Në datën 23.03.2021, operatori ekonomik ankimues “Gjeokonsult & Co” ShPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”*. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.1.9. Në pikën 2, të nenit 42, të ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, përcaktohet se: *“Këshilli i Ministrave miraton autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurës, dokumentet standarde të procedurës së prokurimit, kriteret e vlerësimit dhe përcaktimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër, si dhe të kontratës”*

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, si dhe verifikimet e kryera, Komisioni konstaton se procedura e prokurimit objekt ankimi nuk është procedurë e përsheptuar, e zhvilluar në zbatim të ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, por është një procedurë standarde prokurimi “Shërbim Konsulencë”, e cila i nënshtrohet vetëm detyrimeve që përcaktohen nga ligji nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Procedura e prokurimit objekt shqyrtimi nuk është klasifikuar në asnjë rast si procedurë e përsheptuar rindërtimi nga Këshilli i Ministrave.

III.1.11. Në nenin 20 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet si vijon:

1. Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit;

b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi

c) Bazën ligjore;

d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;

f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;

g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtarit të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

III.1.12. Sa më sipër, KPP gjykon se ankesa e operatorit ekonomik ankimues e paraqitur pranë KPP-së lidhur me anulimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi nuk ka respektuar shkallët e ankimit të parashikuar nga neni 63 i LPP si më sipër cituar. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues duhet të kishte paraqitur ankesë së pari pranë autoritetit kontraktor, në respekt të shkallëve të ankimit. Ankimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për të plotësuar njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. KPP gjykon se, bazuar në faktin që procedura e prokurimit objekt ankimi është një procedurë standarde prokurimi, operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimit, duhet të kishte paraprakisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për shkak të ligjit (ipso lege), ankesa e operatorit ekonomik ankimues nuk është ngritur fillimisht pranë autoritetit kontraktor, nuk do të pranohet nga Komisioni i Prokurimit Publik, si pasojë e mosrespektimit të shkallëve të ankimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” ShPK për procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me objekt “*Hartim Projekt preventiva zbatimi për rikonstruksionin e Godinave të dëmtuara nga tërmeti: Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik, Godina e Anatomisë dhe Salla e Leksioneve të godina e paraklinikut*”, me nr. REF-81547-12-09-2020, me fond limit 11,687,500 lekë (pa TVSh), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
  2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
  3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 447 Protokolli Datë 23.03.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**